




**KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE**



Statuti i Instituti

KLGI



*Kosovo Local Government Institute
Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale
Kosovski Institut za Lokalnu Samoupravu*

STATUTI: KOSOVO LOCAL GOVERNMENT INSTITUTE - KLG I

Kosovo Local Government Institute
Address: Str. Egnatia, E-9, Fl-3, Nr. 17, 10000
Prishtinë, Republic of Kosovo
Tel: +381 (0) 38 522 000
Mobile: +377 (0) 44 253 835
E-mail: info@klgi-ks.com | web: www.klgi-ks.com



NENI 3 – QËLLIMI

3.1. Organizata është themeluar me qëllim:

- 3.1.1 Rritja e efikasitetit të qeverisjes lokale;
- 3.1.2 Ngritja e pjesëmarrjes dhe e ndikimit të profesionalistëve të rinj Kosovar në çështjet në lidhje me administrimin publik, politik bërjen dhe procesin e decentralizimit;
- 3.1.3 Përkrahjen e komunave në ndërtimin e kapaciteteve të qeverisjes lokale për bartjen e shërbimeve, njëkohësisht dhe kuptimin e legjislacionit të ri së bashku me kompetencat e fituara nga statusi ri dhe reformimi i qeverisjes lokale;
- 3.1.4 Këshillim në zhvillimin e programeve në lidhje me qeverisje lokale.

NENI 4 – ANËTARËSIMI


4.1. Anëtarësimi në organizatë është i hapur për çdo person pa marrë parasysh racën, gjininë, orientimin seksual, shtetësinë, kombësinë, religjionin, moshën ose aftësitë fizike.

4.2. Organizata nuk do të aplikoj masë së pagesës për anëtarët e organizatës.

4.3. Për tu bërë anëtar i organizatës personi duhet të bëjë një kërkesë me shkrim. Kuvendi i Anëtarëve do të vendos me shumicë të votave për pranimin ose refuzimin e kërkesës për anëtarësim në organizatë.

4.4. Përfundimi ose suspendimi i anëtarësimit nga Kuvendi i Anëtarëve do të vendoset me shumicë të anëtarëve prezent në mbledhjen e Kuvendit. Kërkesën për përfundim ose suspendim të anëtarësimit për ndonjë person mund ta kërkojë: Kryesuesi i Kuvendit, Drejtori Ekzekutiv ose 1/3 e anëtarëve të organizatës përmes një shkresë që i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit ku edhe specifikohen arsyet. Pas pranimin të kërkesës së tillë Kryesuesi fton një Mbledhje të Jashtëzakonshme të Kuvendit për të diskutuar dhe votuar për kërkesën. Kryesuesi duhet të shpërndajë tek të gjithë anëtarët kërkesën e pranuar.

4.5. Anëtarësimi në organizatë i përfundon personit në mënyrë automatike nëse ai ose ajo dënohen nga Gjykata për vepër penale ose shkelin Kodin e Mirësjelljes, dhe nëse mungon në tri mbledhje të rregullta të Kuvendit të Anëtarëve.



NENI 5 – KUVENDI I ANËTARËVE

- 5.1. Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë qeverisës i organizatës dhe përbëhet prej të gjithë anëtarëve të organizatës.
- 5.2. Kuvendi i Anëtarëve ka përgjegjësinë më të lartë për politikën dhe çështjet financiare të organizatës.
- 5.3. Kuvendi i Anëtarëve ka këto kompetenca, të zgjedh anëtarët e Bordit të Drejtorëve, të aprovoj raportin vjetor financiar dhe atë të punës, të aprovoj përvetësimin e pasurisë mbi vlerën e caktuar si dhe të aprovoj akte të tjera që konsiderohen të nevojshme për funksionimin e organizatës.
- 5.4. Kuvendi i Anëtarëve mund të delegojë ndonjë prej përgjegjësive të tij në ndonjë organ tjetër të organizatës, me vendimin e shumicës së anëtarëve të tij.
- 5.5. Kuvendi i Anëtarëve zgjedh nga radhët e veta njërin prej anëtarëve që të kryej punët e Kryesuesit të Kuvendit të Anëtarëve. Mandati i Kryesuesit është dy-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme.
- 5.6. Kandidatët për Kryesues të Kuvendit të Anëtarëve propozohen nga 1/3 e anëtarëve të organizatës dhe votohet nga shumica e thjeshtë e anëtarëve të Kuvendit. Kryesuesi shkarkohet me shumicën e thjeshtë të votave të Kuvendit të Anëtarëve. Shkarkimi i Kryesuesit mund të kërkohet për arsye të: shkeljes së statutit, kodit të mirësjelljes ose nëse Gjykata e ka dënuar për vepër penale. 1/3 e anëtarëve të Kuvendit mund të kërkojnë shkarkimin e Kryesuesit.
- 5.6. Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve kujdeset për mbledhjet e vjetore të përgjithshme dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Anëtarëve.
- 5.7. Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve nuk mund të jetë zyrtar, punonjës i organizatës apo pjesë e Bordit Këshillëdhënës të organizatës.

NENI 6 – MBLEDHJET E KUVENDIT TË ANËTARËVE

- 6.1. Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve thirren dhe kryesohen nga Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve. Nëse Kryesuesi nuk është në gjendje të kryej këtë obligim atëherë ai/ajo autorizojnë një anëtar të Kuvendit të kryej këto përgjegjësi.
- 6.2. Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku dy herë në vit në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV) ku shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar, si dhe plani për mjetet, e detyrimet e parapara, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm.
- 6.3. Kuvendi i Anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme (MPJ) kurdoherë që kërkohet nga gjysma e anëtarëve.
- 6.4. Lajmërimi me shkrim për MPV ose MPJ duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për takimin do t'u shpërndalet të gjithë anëtarëve së paku shtatë ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.



6.5. Për mbajtjen e mbledhjes është e nevojshme pjesëmarrja e shumicës së thjeshtë të anëtarëve. Nëse kjo shumicë nuk arrihet takimi do të shtyhet për një ditë tjetër. Lajmërimi për takimin e ri do t'u dërgohet të gjithë anëtarëve.

6.6. Secili anëtar i organizatës ka një votë në Kuvendin e Anëtarëve.

6.7. Vendimet në Kuvendin e Anëtarëve do të merren me shumicën e anëtarëve të organizatës.

6.8. Secili anëtar i Kuvendit të Anëtarëve duhet të abstenojë nga votimi ose marrja e vendimit në çështje për të cilën ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.

NENI 7 – DREJTORI EKZEKUTIV

7.1. Drejtori Ekzekutiv i Institutit KLG I është përfaqësues i organizatës dhe në përputhje me këtë statut vepron në emër të organizatës. Mandati i Drejtorit Ekzekutiv është dy (2) vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme.

7.2. Drejtori Ekzekutiv zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve përmes zgjedhjeve sipas nenit (8) të këtij Statuti. Mandati i punës mund të pushoj: në rast vdekje, dorëheqje ose shkarkim nga detyra dhe me zgjedhjen e drejtorit të ri.

7.3. Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv janë:

7.3.1 Organizimin e punës, menaxhimin e përgjithshëm të organizatës si dhe është përgjegjës për punësimin në organizatë.

7.3.2 Të nënshkruaj marrëveshje në dobi të organizatës.


7.3.3 Të emëroj dhe zgjedh përfaqësuesit, t'i përcaktojë kompetencat dhe detyrat e tyre.

7.3.4 Drejtori Ekzekutiv në bashkëpunim me Menaxherin Financiar dhe atë të Programeve prezanton Raportin Vjetor Financiar, të Pasurisë dhe të Punës së organizatës për konfirmim në Bordin i Drejtorëve dhe pastaj për aprovimin final në Kuvendin e Anëtarëve.

7.4. Shkarkimi ose suspendimi i mandatit të Drejtorit Ekzekutiv nga Kuvendi i Anëtarëve do të vendoset me shumicë të anëtarëve prezent në mbledhjen e Kuvendit. Kërkesa për shkarkim ose suspendim së bashku me arsyetimin i drejtohen Kryesuesit të Kuvendit të Anëtarëve i cili thërret jo më larg se 7 ditë nga pranimi i kërkesës, një mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Anëtarëve për të vendosur për kërkesën. Një kërkesë të tillë mund ta bëjnë ose iniciojnë: 1/3 e anëtarëve, kryesuesi i Kuvendit si dhe kryesuesi i Bordit të Drejtorëve.


7.5. Shkarkimi i Drejtorit Ekzekutiv mund të kërkohet për arsyeje të: shkeljes së statutit, kodit të mirësjelljes ose nëse Gjykata e ka dënuar për vepër penale.

7.6. Drejtori Ekzekutiv për punë e tij i raporton Kuvendit të Anëtarëve dhe Bordit të Drejtorëve.



NENI 8 – ZGJEDHJA E DREJTORIT EKZEKUTIV

- 8.1. Drejtori Ekzekutiv zgjidhet për mandat dy vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme nga Bordi i Drejtorëve të organizatës.
- 8.2. Secili anëtar ka të drejtë të kandidoj nëse ai/ajo siguron 1/3 nënshkrimeve të anëtarëve të organizatës, është anëtar i organizatës si dhe ka së paku (1) një-vit përvojë pune në kuadër të stafit të organizatës.
- 8.3. Kandidatët për Drejtor Ekzekutiv dërgojnë kërkesat tek Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve për të garuar për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv. Kërkesa duhet të përmbajë këto informacione: Emri dhe mbiemri, numri personal, data dhe vendi i lindjes, periudha e angazhimit në Institutin KLGJ, një biografi të shkurtër si dhe një letër motivuese për kandidaturën e tij.
- 8.4. Pasi përfundon afati për paraqitjen e kërkesave për të kandiduar për postin e Drejtorit Ekzekutiv, Bordi i Drejtorëve verifikon kërkesat se kanë plotësuar kushtet përkatëse sipas nenit
- 8.5 dhe pas përfundimit të verifikimit caktohet data e votimit të kandidaturave për Drejtor Ekzekutiv nga Bordi i Drejtorëve.
- 8.6. Në zgjedhje mund të ketë vetëm një kandidat. Nëse ka vetëm një kandidat për Drejtor Ekzekutiv, në fletëvotime do të ofrohet edhe mundësia që të të refuzohet kandidati. Në një rast të tillë, Drejtori Ekzekutiv ekzistues vazhdon mandatin deri në organizimin e zgjedhjeve të ardhshme të cilat duhet të ndodhin pas 30 ditëve. Nëse kandidati për Drejtor Ekzekutiv është Drejtori ekzistues dhe nuk fiton votat atëherë Menaxheri i Programeve ushtron funksionimit e drejtorit ekzekutiv deri në zgjedhjet e ardhshme që duhet të mbahen pas 30 ditëve. Një kandidat që është refuzuar një herë në votim për drejtor ekzekutiv nuk ka të drejtë të garoj sërish në zgjedhje për Drejtor Ekzekutiv.
- 8.7. Votat janë të fshehta kurse numërohen në prani të të gjithë anëtarëve prezent. Në rast që asnjëri kandidat nuk merr shumicën e votave shkohet në balotazh.
- 8.8 Anëtarët e Bordit të Drejtorëve nënshkruajn proces-verbalin e votimit duke shpallur edhe Drejtorin Ekzekutiv.
- 8.9. Drejtori Ekzekutiv nuk mund të jetë person që kërkohet nga organet e rendit ose ka kryer ndonjë vepër penale për të cilën është shpallur fajtor me aktgjykim të plotfuqishëm.



NENI 9– BORDI I DREJTORËVE

9.1. Përpos kompetencave të dhëna me këtë statut, Bordi i Drejtorëve duhet të jetë përgjegjës për kontrollin dhe udhëheqjen e çështjeve dhe pasurisë së organizatës. Bordi i Drejtorëve duhet të veprojë çdo herë në pajtim me qëllimin e organizatës.

9.2. Përpos kompetencave të dhëna me këtë statut, Bordi i Drejtorëve do të ketë gjithashtu edhe këto kompetenca:

9.2.1 Të përcaktojë kompetencat dhe detyrat e çdo përfaqësuesi

9.2.2 Të përfaqësoj organizatën dhe të veprojë në emër të organizatës

9.2.3 Të diskutoj dhe aprovoj bashkëpunimet me partner përkatës

(për shembull të përfaqësojë organizatën dhe të veprojë në emër të organizatës, të lidh organizatën në ndonjë marrëveshje me nënshkrimin e dy drejtorëve, të emëroj dhe zgjedh përfaqësues, t'i përcaktojë kompetencat dhe detyrat e çdo përfaqësuesi).

9.3. Bordi i Drejtorëve duhet të përbëhet nga anëtarët e organizatës. Ata do të zgjidhen individualisht nga Kuvendi i Anëtarëve me shumicë. Çdo drejtor do të shërbejë në kohëzgjatje prej (një) viti dhe të qëndrojë në zyrë derisa drejtori i ri merr postin, ose deri në vdekje, dorëheqje ose shkarkim nga detyra.

9.4. Bordi i Drejtorëve do të ketë të paktën 3 (tre) anëtarë.

9.5. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve mund të zgjedhen për mandate të njëpasnjëshme.

9.6. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit me votat e MPV-së dhe MPJ-së të Kuvendit të Anëtarëve.

9.7. Në rast të vdekjes, dorëheqjes ose shkarkimit të anëtarit të Bordit të Drejtorëve, Kuvendi i Anëtarëve duhet të zgjedh pasardhësin për të shërbyer për kohën e mbetur.

9.8. Vendimet në Bordin e Drejtorëve merren me shumicë.


9.9. Bordi i Drejtorëve mund të vendos t'i drejtohet për çfarëdo çështje Kuvendit të Anëtarëve për marrje të vendimit.

9.10. Kurrëfarë pagese ose kompenzimi nuk duhet t'u bëhet drejtorëve pa aprovimin e Kuvendit të Anëtarëve dhe vetëm kur pagesa ose kompenzimi është i arsyeshëm dhe bëhet për punën e kryer për organizatë.

9.11. Secili anëtar i Bordit të Drejtorëve mund të abstenojë prej votimit për marrjen e vendimeve ose për çfarëdo çështje tjetër për të cilën ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.

NENI 10 – ZYRTARËT DHE NËPUNËSIT

10.1. Në rast nevoje Drejtori Ekzekutiv do të punësojë përmes institucionit të konkursit ose të emërojë drejtpërdrejt zyrtarë ose të pranojë persona që të marrin përsipër kryerjen e detyrave ditore të organizatës. Kohëzgjatja e punësimit të tyre duhet të caktohet përmes Kontratës nga Drejtori Ekzekutiv.



V. G

10.2. Zyrtarët duhet të punësohen përmes kontratave të shkruara të cilat detajizojn të gjitha të ardhurat dhe të mirat e tjera që duhet tu paguhen këtyre zyrtarëve. Të gjitha pagesat duhet të jenë të arsyeshme dhe duhet të paguhen vetëm për punën e kryer në organizatë. Marrëveshjet e punës, kontratat dhe të gjitha marrëveshjet e tjera nënshkruhen nga Drejtori Ekzekutiv.

NENI 11 – SHPËRBËRJA E ORGANIZATËS

11.1. Organizata mund të shpërbëhet me vendimin e 2/3 të votave të Kuvendit të Anëtarëve.

11.2. Në rast të shpërbërjes së organizatës asetet, arkiva/dokumentacioni si dhe sendet e luajtshme nuk mund të trashëgohen nga Anëtarët e Organizatës dhe as nga Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës po këto asete dhe sende duhet të dhurohen në ndonjë shoqatë jo-fitimprurëse apo fondacione.

11.3. Kur të vendoset për shpërbërjen e organizatës, Kuvendi i Anëtarëve do të tregojë emrin e shoqatës ose fondacionit që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jetë liruar nga detyrimet e organizatës. Shoqata apo fondacioni i zgjedhura duhet të kenë qëllime të njëjta ose të ngjashme sikurse organizata.

11.4. Gjithashtu organizata e cila do të trashëgoj pasurinë e organizatës do të trashëgoj edhe arkivin dhe dokumentacionin e organizatës përveç nëse ndryshe rregullohet me legjislacionin e Republikës së Kosovës.

NENI 12 – NDRYSHIMET E STATUTIT

12.1. Statuti i tanishëm mund të ndryshohet me vendimin e dy të tretave të votave të Kuvendit të Anëtarëve.

NENI 13 – PERIUDHAT E RAPORTIMIT DHE VITI FINANCIAR

13.1. Drejtori Ekzekutiv paraqet raporte vjetore para Bordit të Drejtorëve dhe Kuvendit të Anëtarëve, MPV ose kurdoherë që kërkohet nga një MPJ.


13.2. Viti financiar i organizatës përputhet me vitin kalendarik.

NENI 14 – DISPOZITA TË TJERA

14.1. Ky statut hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Drejtori Ekzekutiv, si përfaqësues i autorizuar i Institutit KLGI.

Valmiri Gashi

Drejtor Ekzekutiv - Kosovo Local Government Institute





**KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE**

Kosovo Local Government Institute
Address: Str. Egnatia, E-9, FI-3, Nr. 17, 10000
Prishtinë, Republic of Kosovo
Tel: +383 (0) 38 522 000
Mobile: +383 (0) 44 253 835
E-mail: info@klgi-ks.com | web: www.klgi-ks.com